

Z.A.B.Y
Shk. Bashkia
N. U. Bot. 16
25/01/2019



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 15 Datë 10/01/2019

Per miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujore te perroit te Tacit (Rehoves) dege e lumit Osum, për prodhim hidroenergjie nga subjektit "ANLET ENERGY" sh.p.k në Bashkia Kolonje Qarku Korçe.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni" te ndryshuare me V.K.M Nr 718 te dates 12/10/2016, Vendimit te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore" per paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit "ANLET ENERGY" sh.p.k, me propozim të A.B.U. Seman, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

VENDOSI:

Miratimin ne parim per perdorimin të burimit ujqor te perroit te Tacit(Rehoves) dege e lumit Osum, për prodhim hidroenergjie nga subjektit "ANLET ENERGY" sh.p.k në Bashkia Kolonje Qarku Korçe.

HEC TACI 2

Perroi i Tacit(Rehoves) dege e lumit Osum me keto te dhena:

Vepra e marrjes Nr1

X=558617 Y=4466190 Z=1030 m

- Prurja mesatare 0.095 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.132 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.010 m³/sek.

Vepra e marrjes Nr2

X=558629 Y=4466250 Z=1030 m

- Prurja mesatare 0.308 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.430 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.033 m³/sek.


Godina e centralit

X=553640 Y=4466248 Z=870 m

Per perdorimin e ketij burimi ujqor duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
 - Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
 - Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
 - Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
 - Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.
- Ngarkohet ABU Seman per zbatimin e ketij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN
Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBU SEMAN
Baki BALA

